



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "MIHAL SHAHINI" CERRIK

Nr. 444 prot.

Cerrik, më 07.11.2024

Lënda: Shpallje vendi vakant (për punonjes mbështetës)

Drejtuar : **AGJENCISE KOMBETARE TE PUNESIMIT DHE AFTESIVE (AKPA)**

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

TIRANE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave Nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të Udhëzimit Nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë menaxhimit të burimeve , përbërjes së njësisë së zhvillimit të institucioneve ,ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit".

Ofruesi i AFP-se , Shkolla e Mesme Profesionale " Mihal Shahini " Cerrik , njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin - punonjës mbështetës në funksionin punonjes i baze prodhuese.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë nivelin arsimor të mesëm ose shkollë të mesme profesionale, në fushën në shpalljen për pozicionin përkatës;
- b) të ketë përvojë në punë të paktën një vit sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
 - jetëshkrimin (CV-në);
 - kartën e identitetit;
 - diplomën/deftesë e shkollës së mesme
 - librezën e punës;
 - çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
 - vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
 - vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm ;
 - të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.
- Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës

14/11/2024

DREJTORI

ERINA DISHO

